

NDIKIMI I ACIDOZËS NË SHFAQJEN E ÇALIMIT NË GJEDHË IMPACT IN ACIDOSIS SHOWING LAMENESS IN CATTLES

LUIGJ TURMALAJ, FEJZO SELAMI*, VASILIKA DINI, BEJO BIZHGA, KASTRIOT KORRO

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Universiteti Bujqësor i Tiranës

PËRMBLEDHJE

Në këtë studim, të kryer në EDE, rezultoi një lidhje midis tyre, në masën 25 %. Në mjekimin e laminiteve janë zbatuar skema të ndryshme terapeutike ku bazën e përbëjnë skemat parandaluese dhe mjekuese. Në skemat parandaluese përfshihen banjëzimi i thundrave me solucione dezinfektuese, si dhe me antibiotik nga grupi i tetraciklinës. Gjithashtu zbatohet kalendari i prerjes së thundrave. Mjekimi terapeutik realizohet me mjekim lokal dhe sistematik. Në mjekimin lokal u përfshi përdorimi i solucioneve dezinfektuese me bazë jodi si dhe solucione me antibiotikë dhe me pomada të ndryshme, me qëllim zbutje dhe antimikrobike. Në trajtimin sistematik, prioritet merr përdorimi i antibiotikëve me selektivitet për efektin mbi koriumin e thundrës, si derivatet e linkozamideve (lincomycine-spectomycine) të shoqëruara me antiinflamatorë jo steroidale (NSAID) nga derivatet e acidit aminonikotinicë si flunixinë- meglumine, si dhe antiinflamatorët steroidale nga grupi me efekt të zgjatur, si deksametazoni. Metoda më e mirë është parandalimi nëpërmjet mbajtjes nën kontroll të dietës ushqimore.

Fjalë çelës: gjedhë, acidozë, çalim, mjekim, desinfektant, antibiotikë.

ABSTRACT

In this study realized in EDE resulted a link stuck between theirs about 25 %. The relationship between acidosis and screening of laminitis is associated with hypo function continued with ischemic to hoof. In the treatment of laminitis different therapeutic schemes are applied, which constitute the basis of preventive and therapeutic schemes. Schemes included in preventive washmen of the hoofed disinfectants with solutions, as well as by antibiotic group tetracycline. Also the cutting hoofed calendar is applied. Therapeutic treatment is achieved with local and

systemic treatment. In local treatment is included the use of solutions based disinfectant and iodide solutions with antibiotic ointment and with different order and domestication antimicrobial. Parenteral antibiotic is used in the treatment group linkozamides as lincomycine, spectomycine etc.. The best method is prevention by keeping under control the diet food. Food diet should contain as much as possible fiber, cellulose and therefore glucides are eliminated.

Key words: cattle, acidosis, lameness, disinfectant treatment, antibiotic treatment.

HYRJE

Ndikimi i acidozës shfaq disa efekte fiziologjike, duke përfshirë inflamacionin dhe laminitin e përhapur pa infeksion. Mendohet se bazat ushqyese për ekzistencën e sëmundjeve duke përfshirë etiologji të shumëllojshme të faktorëve ndërveprues, të tilla si çrregullimet metabolike dhe tretëse, stresi i paspjelljes, trauma të lokalizuara, të cilat çojnë në çlirimin e substancave vazoaktive, të cilat me anën e mekanizmit vazokonstriktor shkaktojnë ndryshime degjenerative në thundra. Shpërthimi i shfaqjes së çalimeve (laminiteve) është në varësi të frekuencës, intensitetit dhe shmangia në vazhdimësi, si mekanizëm përgjegjës për çlirimin e substancave vazoaktive (4; 7). Lidhja kritike midis acidozës dhe shfaqjes së laminitit është e shoqëruar me hipofunksion të vazhdueshëm, me mosfurnizim të thundrës me gjak (5). Ndjekja e ecurisë së të ushqyerit dhe praktikata e mbarështimit duhet të zbatohen për të pakesuar përhapjen e laminiteve (10). Shkalla e pH kritik në rumen është < 5.0 gjatë acidozës akute dhe < 5.5 gjatë acidozës subakute. Autor të ndryshëm kanë treguar se glukoza do të uli pH deri < 4.5 pas 14 orësh nga përdorimi. Gjatë acidozës ruminale vërehet rritje e kolonive të *Streptococcus bovis* dhe rritje e prodhimit të acidit laktik. Kjo

shoqërohet me uljen e kolonive të *Megasphaera elsdenii* dhe *S. ruminantium*. Ndryshimet ruminale shoqërohen njëkohësisht dhe me ndryshime të theksuara në vazhdimësi. Rritja e acidit organik, kryesisht e acidit laktik dhe ulja e pH shkakton ulje të tkurrshmërisë dhe stazë ruminale, ruminitis dhe deri në hiperkeratozë të mukozës ruminale. Këto ndryshime krijojnë premisa për depërtimin e bakterieve si *Fusobacterium necrophorum* nëpërmjet murit ruminal drejt mëlçisë ku shfaqin absese (2,5). Element tjetër, që ndikohet nga situata e mësipërme e ndikimit bakterial mbi murin ruminal, është rritja e presionit osmotik ruminal, ulja e volumit ekstraqelizor me dehidratim, ulja e aktivitetit të zembrës, ulje e depërtimit anësor, ulje e furnizimit të veshkave me gjak, gjendje shoku dhe deri ngordhje të kafshës (2). Në shumë raste që punohet me lopët e qumështit, ndryshimi nuk është i acidozës akute, aq më tepër i acidozës subklinike, me akumulim shumë të pakët të acidit laktik, të përcaktuar në rumen, por megjithatë pH ulet. Rastet ditore të një pH<5.5 rritin ndjeshmërinë të gjedhët në një shkallë të ulët të acidozës subklinike. Simptomat janë ulje e apetitit, humbje e peshës trupore, diare dhe çalim (6). Çalimet shfaqen në forma të ndryshme: akute, subklinike dhe kronike. Lidhja midis acidozës dhe çalimit shfaqet e shoqëruar me ndryshime të furnizimit me gjak të enëve të vogla anësore (5).

MATERIALI DHE METODA

tudimi u krye në 20 krerë lopë qumështi të cilat u monitoruan për praninë e laminiteve të shkallëve të ndryshme. Në kriteret bazë për përcaktimin klinik të laminiteve u vlerësua kontrolli me palpim i kurorës së thundrave, shkalla e dhimbjes, nxehtësia, ngjyra, pozicioni i mbajtjes së këmbës me pezmatim të thundrës. Këto vlerësime u bënë për laminitet e shkallës së parë. Në laminitet më të avancuara u vlerësuan çrregullimet e pakthyeshme në konstruktin e thonjve, rënia e thoit dhe rritja e indit të granulimit. Objektivi i këtij studimi synon për të nxjerr në dukje skemën më të mirë të mundshme në lidhje me mjekimin e laminiteve në stadi të ndryshme të zhvillimit të tyre. Qëllimi i studimit ishte nxjerrja e shkallës së ndërlidhjes midis acidozës ruminale dhe laminiteve, si dhe përcaktimi sa më i saktë si kontrollit klinik dhe i mjekimit efikas të tyre. Pasi u ekzaminuan nga ana klinike, ato u ndanë në dy grupe me 10 krerë

lopë. Në grupin e parë u zbatua mjekimi vetëm për laminitet e shfaqura pa ndërhyrë mbi parambrojtjen dhe terapinë për krerët me acidozë ruminale. Konkretisht në 10 krerët e grupit të parë u shfaqën shenjat e laminitit akut në 6 krerë dhe 3 prej tyre kaluan në laminit kronik. Në këtë grup 4 krerë shfaqën shenjat e acidozës ruminale akute dhe kronike. Për këtë grup u përcaktua si protokoll farmaceutik: trajtimi lokal vetëm pas prerjes së thoit dhe përpunimit kirurgjikal me sprajt me dezinfektant, banjëzim me solucion 20 % të sulfatit të bakrit, të përzier me 10% oksitetraciklinë. Mjekimi për rastet kronike u shoqërua dhe me sprajt me solucionin 10% të tinkturës së jodit. Duhet të theksojmë që në këtë grup nuk u kryen mjekime për acidozën ruminale të shfaqur.

Për lopët e grupit të dytë, pas ekzaminimit klinik për praninë e çalimeve në shkallë të ndryshme zhvillimi, u përcaktua kombinimi i trajtimit lokal me trajtimin e përgjithshëm. Pra u aplikua edhe trajtimi me antibiotik, antiinflamator dhe kortizonik. Nga monitorimi i rregullt dhe gjetjet klinike të këtyre krerëve rezultoi prania e laminiteve në 6 krerë, 3 me laminit kronik dhe 3 krerë me acidozë ruminale. Fillimisht u krye mjekimi i 3 krerëve që shfaqën njëkohësisht si acidozën ruminale dhe laminitin. Për acidozën ruminale u përdor solucion i karbonatit të Na deri në 300-500 ml i/v të shoqëruar me përmirësim të racionit ushqimor duke përdorur monensin dhe karbonat natriumi nga goja. Në lidhje me trajtimin e laminiteve për këtë grup u përdor trajtimi lokal dhe për rastet kronike edhe trajtimi sistematik me mikospectine (linkomycine + spectinomycine) 1ml/10 kg peshë për tri ditë rresht, si dhe antiinflamator jo steroidial nga derivatet e acidit aminonikotinik (NSAID) Flunixin-Meglumin 2.5 ml/kv peshë të gjallë i/m, antiinflamator steroidial si Dexametasone 1 ml/kv peshë të gjallë i/m.


REZULTATET DHE DISKUTIME

Ecuria e shërimit të çalimeve me këtë trajtim në grupin e parë rezultoi e ngadaltë dhe u shfaqën recidiva në 3 krerë, pra në 30 % të të gjithë grupit.

Ecuria e shërimit të çalimeve në grupin e dytë, ku u përdor kombinimi i mjekimit lokal me mjekimin e përgjithshëm, ishte e lartë ku pati vetëm 1 recidivë, pra 10 % të krerëve

Grupi	Nr. i krerëve	Krerë të trajtuar lokalisht	Krerë të trajtuar sistemik.	Krerë të shëruar	Krerë të pashëruar	Efikasiteti në %	Recidiva në krerë	Recidiva në %
Gr. I	10	10	-	4	6	40	4	30
Gr. II	10	10	10	9	1	90	1	10

Tab 1. Krahasimi i rezultateve të përdorimit të dy skemave të mjekimit.



Graf.nr.1. Paraqitja e rezultateve të efektivitetit të mjekimit të laminitëve.

Për grupin e parë, krerët që shfaqën acidozë ruminale kaluan një shkallë më të rëndë të laminitit. 2 prej tyre me laminit kronik, me ulçeracion të thundrës. Nga 6 rastet me laminit kronik pas banjëzimit dhe trajtimit lokal për laminitet kronike për 10 ditë rresht u vu re një përqindje e ulët e shërimit të plotë vetëm për tre krerë, si dhe shfaqja e recidivave për tre krerë.

Për krerët e grupit të dytë u konstata se ecuria e trajtimit të kombinuar rezultoi me efekte pozitive farmakoklinike. U eliminua plotësisht acidoza ruminale nga krerët me laminit akut si dhe nga 3 krerët me laminit kronik, 2 prej të cilëve u shëruan plotësisht dhe 1 rast dha recidivë.

Lidhja e acidozës ruminale me laminitet shpjegohet me qarkullimin e endotoksinave të prodhuara në rumen edhe në indin e koriumit të thunders, duke shkaktuar vazokonstrukcion të kapilarëve si dhe uljen e trofikës indore dhe hipoksi të qelizave të koriumit (3, 5).

Pikërisht në krerët e grupit të parë të patrajtuar për acidozën ruminale përqindja e shërimit është shumë e ulët 50 % dhe gjithë krerët me acidozë ruminale shfaqën recidiva për laminit kronik (10). Në grupin e dytë ku u zbatua skema e plotë terapeutike dhe u trajtuan krerët me acidozë ruminale u vu re një shkallë e lartë e shërimit deri në 90 % dhe vetëm me një recidivë. Efektiviteti i terapisë së kombinuar së pari për acidozën ruminale dhe të laminit lokalisht dhe

sistemikisht përforcon edhe njëherë hipotezën se një nga shkaqet kryesore të laminitit të lopëve të qumështit pas pjelljes është acidoza ruminale, si dhe metritet dhe mastitet (9).

PËRFUNDIME

Bazë për parandalimin dhe mjekimin e çalimeve në lopët e qumështit mbetet parandalimi dhe trajtimi i acidozës ruminale, e cila rezultoi në një korrelacion të lartë me shfaqjen e tyre.

Për të siguruar një efikasitet të lartë të terapisë duhet që për laminitet e shkallës së rëndë të arrihet kombinimi i trajtimit lokal me atë të përgjithëshëm.

Protokolli i përdorur në grupin e dytë siguroi shërim të plotë të krerëve të trajtur si dhe nivel të ulët të shfaqjes së recidivave të kësaj patologjie.

Metoda më e mirë është parandalimi nëpërmjet mbajtjes nën kontroll të dietës ushqimore, e cila duhet të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur elementin fibër, pra celulozë dhe të eliminohen glucidet që janë faktorë predispozues për acidozën ruminale dhe si pasojë edhe të laminitit.

LITERATURA

1. Anderson L. (1980). Frequency of studies and clinical observations in bovine laminitis. Nord. Vet. Med, 32, 301-307.

2. Anderson L.; Bergman A. (1980) Pathology of bovine laminitis especially as regards vascular lesions. *Acta Vet Scand.* 21, 559-566.
3. Andersen P. H., Heselholt M., Jarlov N. (1994). Endotoxin and arachidonic acid metabolites in portal, hepatic and arterial blood of cattle with acute ruminal acidosis. *Acta Vet. Scand.* 35; 223-234.
4. Bergsten C. (1993). A photometric method for recording hoof diseases in cattle, with special reference to hemorrhages of the sole. *Acta Vet. Scand.* 34, 281-286.
5. Drewe J. C., Beglinger, and G. Fricker. (2001). Effect of ischemia on intestinal permeability of lipopolysaccharides. *Eur. J. Clin. Invest.* 31: 138-144.
6. Keunen J. E., Plaizier L., Kyriazakis T. F., Duffield T. M., Widowski M. I., Lidinger B.W. (2002). Effect of a subacute ruminal acidosis model on the diet selection of dairy cows. *J. Dairy Sci.* 85: 3304-3313.
7. Livesey C. T.; Fleming F. L. (1984). Nutritional influences on laminitis, sole ulcer and bruised sole in Friesian cows. *Vet. Rec.* 114, 510-512.
8. Nocek J. E., Kautz, W. P., Leedle, J. A. Z., Allman J. G. (2002). Ruminant supplementation of direct-fed microbials on diurnal pH variation and in situ digestion in dairy cattle. *J. Dairy Sci.* 86: 331-335.
9. Scott G. B. (1988). Lameness and pregnancy in Friesian dairy cows. *Br. Vet. J.* 144, 273-281.
10. Weaver D. (1979). Prevention of laminitis in dairy cattle. *Bov. Pract.* 14, 70-72.